

VENDIM
Nr. 8, datë 12.1.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 426, DATË 15.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E KOMISIONIT KOMBËTAR PËR NOMENKLATURËN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12/2, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 426, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe në përbërje ka përfaqësues nga:

- | | |
|--|------|
| a) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | 1; |
| b) Ministria e Brendshme | 1; |
| c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë | 1; |
| ç) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | 1; |
| d) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë | 1; |
| dh) Ministria e Drejtësisë | 1; |
| e) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 1; |
| ë) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | 1; |
| f) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | 1; |
| g) Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes | 1; |
| gj) Banka e Shqipërisë | 1; |
| h) Shërbimi Kombëtar i Punësimit | 1; |
| i) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | 1; |
| j) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | 1; |
| k) Instituti i Sigurimeve Shoqërore | 1; |
| l) Qendra Kombëtare e Biznesit | 1; |
| ll) INSTAT-i | 2.”. |

b) Në fund të pikës 3 shtohen fjalët “... dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve njoftojnë INSTAT-in ...”.

2. Ngarkohen Instituti i Statistikave dhe institucionet e përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama